



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim C-A

Ngarkesa: 8 kredite; 15 orë leksione + 65 orë seminare;

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Master” në Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim;

Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme:

Studenti duhet të jetë i aftë të njohë fazat e përkthimit dhe të përkthejë tipologji të ndryshme tekstesh dhe situatash. Të analizoje dhe të informohet mbi zhvillime të ndryshme të jetës si dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi to.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë

1. Të analizoje dhe përdorë në mënyrë profesionale teknikat e interpretimit dhe të përkthimit
2. Të aftësohet për të bërë guidë turistike dhe interpretimin
3. Të përkthejë dhe të pajisë me bibliografi shpjeguese dhe burimore përkthimet e tij.

Rezultatet të pritshme:

1. Të jetë i aftë për të zhvilluar kompetencën e të folurit rrjedhshëm, të arsyetimit, argumentimit dhe sistemimit të njohurive si nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve ashtu edhe nëpërmjet diskutimeve dhe paraqitjes së punimeve dhe projekteve përgjatë kursit.
2. Të jetë i aftë për të ushtruar një mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ në interpretimin e fenomeneve të ndryshme